



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.945/2021**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevc, anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Driton Daçi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosoves, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Pranohet** si i bazuar apeli Anr.945/2021 i datës 04.11.2021, kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Driton Daçi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosoves, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, më të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 2020A/03D.

**II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet kandidatit për anëtare të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosoves, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, në Vendvotimin: 2020A/03D

**III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.

**A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.945/2021, e paraqitur nga kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Driton Daçi nga Subjekti Politik Partia

Demokratike e Kosoves, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me të cilën pretendon se në vendvotimin 2020Z/03D sipas FRP ka 63 vota ndërsa në rezultatet përfundimtare të publikuara nga KQZ në këtë qendër ka vetëm 3.

Në apel ka bashkangjitur FRP për votat e numruara për kandidatet për asamble në këtë qendër votimi.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se kandidati për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Driton Daçi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosoves, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin e lartcekur, PZAP pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i paraqitur nga kandidati në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimin e lartcekur është i bazuar .

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket vendvotimit të vendosur si në dispozitiv II të këtij vendimi, nga se rezulton se në Formularin e Rezultateve të Kandidateve për anëtar të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Driton Daçi nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosoves, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, Driton Daçi ka 63 vota ndërsa ky numër nuk rezulton të jetë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatiit përfundimtar me deklaratën e votuesit andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në vendvotimin e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj ky panel, vlerëson se rinumërimi në këtë vendvotim e bënë procesin e rinumërimin të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e rinumërimin të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparencja, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë,

transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Anr.945/2021 më datën 07.11.2021.**

**Kryesuese e Panelit  
Kymete Kicaj**



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.